

Nr. 119 Prot.
Dt. 03.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 89/3 Prot.

Tiranë, më 27.03 .2026

Lënda: Përcillen vendimet e Bordit të Akreditimit

KOLEGJIT UNIVERSITAR "TBU"
Rruga Rezervat e Shtetit, 1045

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 26 Shkurt 2026, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimet e Bordit të Akreditimit Nr. 18 dhe 19, datë 26.02.2026.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


Anisa Subashi



Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr.Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë;

Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

Faqe 1 nga 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 18, datë 26.02.2026

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË “ADMINISTRIM BIZNESI”, ME PROFILE
“MENAXHIM” DHE “KONTABILITET-FINANCË”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR
“TBU”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 26.02.2026, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Administrim Biznesi”, me profile “Menaxhim” dhe “Kontabilitet-Financë”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në “Administrim Biznesi”, me profile “Menaxhim” dhe “Kontabilitet-Financë”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.386, datë 05.08.2011
- d) Akti zyrtar i riorganizimit: Shkresë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 3575/3 Prot., datë 07.05.2019
- e) Akreditimi i mëparshëm: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 41, datë 12.03.2021
- f) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “TBU”
- g) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti Biznes dhe Financë
- h) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit / 2 semestra
- i) Kredite (ECTS): 60 kredite

- j) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- k) Gjuha e mësimdhënies: Shqip
- l) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar "TBU"
- m) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të mëparshëm të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandime;
- f. Institucioni ka përmbushur katër rekomandime plotësisht dhe tre kryesisht, të lëna nga akreditimi i mëparshëm;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisht të *"Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **"i përmbush pjesërisht standardet"**, me mangësi si më poshtë:
 1. Kualifikimi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
 2. Numri i ulët i personelit administrativ dhe mungesa e personelit ndihmës-mësimor, pavarësisht numrit të ulët të studentëve, ndikon në cilësinë e dokumentacionit dhe të shërbimeve të institucionit, në funksion të këtij programi studimi.
 3. Mungesa e përditësimit të plotë të kuadrit rregullator institucional në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të këtij programi studimi, me kërkesat më specifike për organizimin dhe vlerësimin e detyrimeve përmbyllëse, si dhe me përcaktimin e qartë të strukturave dhe ndarjes së përgjegjësiive ndërmjet tyre në përputhje me ndryshimet organizative të institucionit.

4. Mungesa e detajimit të plotë të literaturës për çdo temë në syllabuset e programit të studimit, si dhe përdorimi në disa raste i literaturës së papërditësuar me botime të viteve të fundit.
5. Mungesa e një studimit të mirëfilltë të tregut të punës, në funksion të këtij programi studimi.
6. Numri i studentëve në profilin Financë-Kontabilitet paraqet tendencë në rënie, ndërkohë që dallimet në përmbajtjen kurrikulare ndërmjet dy profileve të këtij programi studimi janë të kufizuara, duke u reflektuar vetëm në dy lëndë.





Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master Profesional në **“Administrim Biznesi”**, me profile **“Menaxhim”** dhe **“Kontabilitet-Financë”**, të Kolegjit Universitar **“TBU”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **25.02.2029**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar

INDRIT HOXHA		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar
MIRJETA BEQIRI		Anëtar
NIKOLLA QAFOKU		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar/Stakeholder
LORETA KONDILI		Anëtar
GERD HOXHA		Student/Vëzhgues

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 26.02.2026, “Për akreditimin periodik të programit të studimit Master Profesional në “**Administrim Biznesi**”, me profile “**Menaxhim**” dhe “**Kontabilitet-Financë**”, të Kolegjit Universitar “TBU”, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të jetë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, si edhe të rrisë qëndrueshmërinë e tij nga një vit akademik në tjetrin.
2. Institucioni, të rrisë numrin e personelit administrativ dhe të punësojë personel ndihmës – akademik, për një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe për të rritur cilësinë e shërbimit dhe të dokumentacionit të institucionit, në funksion të këtij programi studimi.
3. Institucioni, të përditësojë kuadrin rregullator në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të programit të studimit, duke përfshirë përcaktimin më të detajuar të kërkesave për organizimin dhe vlerësimin e detyrimeve përmbyllëse, si dhe qartësimin e strukturave përgjegjëse dhe të ndarjes së detyrave ndërmjet tyre, në përputhje me ndryshimet organizative të institucionit.
4. Institucioni, të sigurojë detajimin e plotë të literaturës për çdo temë në syllabuset e programit të studimit dhe të përditësojë referencat bibliografike me botime të viteve të fundit, me qëllim garantimin e përputhjes së përmbajtjes mësimore me zhvillimet bashkëkohore të fushës.
5. Institucioni, të realizojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, në funksion të këtij programi studimi.
6. Institucioni, të rishikojë strukturën dhe përmbajtjen kurrikulare të profileve të programit të studimit, me qëllim rritjen e dallueshmërisë ndërmjet tyre dhe përmirësimin e atraktivitetit të profilit Financë-Kontabilitet, duke adresuar njëkohësisht tendencën në rënie të numrit të studentëve të regjistruar në këtë profil.
7. Institucioni, të përcaktojë indikatorë të qartë për vlerësimin e performancës së marrëveshjeve të bashkëpunimit, si dhe të marrë në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjeve specifike vetëm për praktikën mësimore për këtë program studimi.
8. Institucioni, të rrisë përpjekjet për ndërkombëtarizimin e këtij programi studimi, duke filluar me krijimin ose forcimin e një njësie të dedikuar për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe projektet, si dhe duke zgjeruar bashkëpunimet ndërinstitucionale përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, zhvillimit të mobiliteteve për personelin akademik, administrativ dhe studentët, si dhe rritjes së pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, përfshirë programet Erasmus+.
9. Institucioni, të shohë mundësinë e rishikimit të përmbajtjes së këtij programi studimi, duke përfshirë lëndë që lidhen me sipërmarrjen, inovacionin, kapitalin human, digjitalizimin dhe inteligjencën artificiale, me qëllim pajisjen e studentëve me kompetencat bazë të nevojshme për drejtimin e biznesit, si financa, sistemet e informimit dhe marketingu digjital.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “TBU”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 2 (dy) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 19, datë 26.02.2026

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË “ADMINISTRIM BIZNESI I AVANCUAR”, ME
PROFILE “MENAXHIM”, “KONTABILITET-FINANCË”, “E DREJTË BIZNESI”, TË
KOLEGJIT UNIVERSITAR “TBU”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 26.02.2026, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me profile “Menaxhim”, “Kontabilitet-Financë”, “E drejtë Biznesi”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me profile “Menaxhim”, “Kontabilitet-Financë”, “E drejtë Biznesi”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.386, datë 05.08.2011
- d) Akti zyrtar i riorganizimit: Shkresë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 3575/3 Prot., datë 07.05.2019
- e) Akreditimi i mëparshëm: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 42, datë 12.03.2021
- f) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “TBU”
- g) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti Biznes dhe Financë
- h) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra

- i) Kredite (ECTS): 120 kredite
- j) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- k) Gjuha e mësimdhënies: Shqip
- l) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar "TBU"
- m) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbylljes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të mëparshëm të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandime;
- f. Institucioni ka përmbyllur katër rekomandime plotësisht dhe tre kryesisht, të lëna nga akreditimi i mëparshëm;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisht të "*Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"*" dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është "**i përmbyll pjesërisht standardet**", me mangësi si më poshtë:

1. Kualifikimi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
2. Numri i ulët i personelit administrativ dhe mungesa e personelit ndihmës-mësimor, pavarësisht numrit të ulët të studentëve, ndikon në cilësinë e dokumentacionit dhe të shërbimeve të institucionit, në funksion të këtij programi studimi.
3. Mungesa e përditësimit të plotë të kuadrit rregullator institucional në përputhje me ndryshimet e miratuara në planet mësimore të këtij programi studimi, me kërkesat më specifike për organizimin dhe vlerësimin e detyrimeve përmbyllëse, si dhe me

- përcaktimin e qartë të strukturave dhe ndarjes së përgjegjësive ndërmjet tyre në përputhje me ndryshimet organizative të institucionit.
4. Mungesa e një studimit të mirëfilltë të tregut të punës, në funksion të këtij programi studimi.
 5. Numri jashtëzakonisht i ulët i studentëve të regjistruar në profilet e programit të studimit, cënon funksionimin dhe qëndrueshmërinë e programit.






Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi i Avancuar”, me profile “Menaxhim”, “Kontabilitet-Financë”, “E drejtë Biznesi”, të Kolegjit Universitar “TBU”.
2. Akreditimin e programit të studimit vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2025-2026 dhe që aktualisht ndjekin këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
INDRIT HOXHA		Anëtar

DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar
MIRJETA BEQIRI		Anëtar
NIKOLLA QAFOKU		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar/Stakeholder
LORETA KONDILI		Anëtar
GERD HOXHA		Student/Vëzhgues